Falkenbergs kommun

Jepni vërejtje për kopshtin dhe shkollën

Nëse veprimtaria jonë nuk përmbush pritshmëritë tuaja ose nëse ju apo fëmija juaj jeni të pakënaqur me diçka, mund të na kontaktoni. Vërejtjet tuaja janë të rëndësishme për punën tonë të vazhdueshme për përmirësim. Ne punojmë vazhdimisht për zhvillimin e veprimtarive tona.

Ankesat dhe vërejtjet duhet t'i paraqiten institucionit sipas një radhe të caktuar. Nëse nuk jeni të kënaqur pas trajtimit të çështjes, mund ta përcillni ankesën ose vërejtjen në nivelin e radhës. Ankesat dhe vërejtjet paraqiten sipas kësaj radhe:

1. Kontaktoni institucionin.
2. Kontaktoni drejtorin/drejtoreshën.
3. Kontaktoni drejtuesin/drejtuesen e veprimtarisë ose njësinë mbështetëse.
4. Kontaktoni drejtuesin/drejtuesen e administratës.
5. Nëse nuk jeni të kënaqur me mënyrën e trajtimit të çështjes, kontaktoni autoritete të tjera.

Në faqen tonë të internetit gjeni më shumë informacion se si të paraqisni ankesa dhe vërejtje. Aty mund t'i paraqisni gjithashtu ankesat dhe vërejtjet në mënyrë digjitale.

Falkenbergs kommun
311 80 Falkenberg

Kontaktcenter: 0346-88 60 00

E-post: kontaktcenter@falkenberg.se
kommun.falkenberg.se